

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02-180/05/22
Datë: 22.04.2022 .

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.9.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:

FTESË

Për: Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Nga: Shpejtim Gacaferi – kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut;
Lënda: Mbledhja e pestë - (2022) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Data: 29.04.2022, ora 10⁰⁰.



Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Raport i buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2022;
3. Informatë lidhur me gjendjen e shërbimeve publike në komunën e Junikut;
4. Shqyrtimi dhe shfuqizimi i vendimit nr.02/04/21 të datës 26.02.2021 për subvencionimin e qytetarëve të Komunës së Junikut që kanë rezultuar pozitiv me testin RT-PCR SARS COV-2 nga IKSHPK;
5. Nxjerrja e vendimit për fillimin e procedurave për ndryshim të Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2023
6. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Komitetit për Komunitete;
7. Të ndryshme;



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REFERENC-Ë:	Numër: 02-04/22
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATË/A	30.03.2022
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL:

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së katërt (4) të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 30.03.2022, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. **Shpejtim Gacaferi**: i cili në fillim përshëndeti kryetarin e Komunës: z. Ruzhdi Shehun, nënkryetarin e Komunës së Junikut z. Besart Tofaj, drejtorët e drejtorive komunale, Komandantin e stacionit të Policisë në Junik z. Rasim Sylja, anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit.

Anëtarët prezent:

1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK
2. Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK
3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK
4. Albertina Gacaferi - Anëtare, LDK
5. Ermelinda Lllolluni - Anëtare, LDK
6. Lirjeta Shehu - Anëtare, LDK
7. Leonard Lllolluni - Anëtar, AAK
8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK
9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK
10. Rajmonda Krasniqi - Anëtare, AAK
11. Erleta Qestaj - Anëtare, AAK
12. Festina Maloku - Anëtare, AAK
13. Lulzim Gacaferi-Anëtar,LVV
14. Eliza Pepshi- Anëtare, LVV
15. Xhemë Tofaj-Anëtar,LVV

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Kërkesë për ndryshimin e planit të buxhetit për të hyrat vetanake për vitin 2021;
3. Kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2021 në vitin 2022;
4. Shqyrtimi i kërkesës për përbërjen e anëtareve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
5. Kërkesë për miratimin e iniciativës për bashkëpunim ndërkomunal – ndërkombëtar;
6. Raporti i obligimeve kontraktuale për vitin 2021;
7. Shqyrtimi në lexim të parë i planit të punës së Kuvendit për vitin 2022;
8. Të ndryshme;

z. Shpejtim Gacaferi: A jeni të pajtimit me këtë të rendit të ditës?

E hedhi në votim këtë rend të ditës.

Nga 15 prezent, për ishin 15, asnjë kundër, asnjë abstenim, kalon.

Pika e parë e rendit të ditës

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara

z. Shpejtim Gacaferi: Sa i përket pikës së parë të rendit të ditës, materialet i keni përpara a ka dikush sa i për këtë procesverbalit që ka diskutuar, dhe nuk i është shënuar diskutimi? E hedhi në votim.

Nga 15 prezent, për ishin 15, asnjë kundër, asnjë abstenim, kalon.

Pika e dytë e rendit të ditës

2. Kërkesë për ndryshimin e planit të buxhetit, për të hyrat vetanake për vitin 2021,

z. Shpejtim Gacaferi: Sa i përket pikës së dytë të rendit të ditës, materialin e keni marr me kohë në Komitetin për Politikë dhe Financa ka kaluar me 5 vota, e hapi diskutimin fjalën ku fjalën e kaloj të Sadri Krasniqi.

z. Sadri Krasniqi: Falemderit Kryesues përshëndetje për të gjithë unë desha të diskutoj të projekti i kanaleve të ujitjes a ka te specifikuar se ku do të ndërtohen? Apo veç janë të bartura si punë shtesë nga viti i kaluar, desha te kërkoj informacioni shtesë edhe të shëndetësia me duket pak të planifikuara, ne si grup po pajtohemi.

z. Leonard Lolluni: Ne si grup i AAK-së pajtohemi me bartjen por mos të behet bartja me një diferencë të madhe dhe tani mos të realizohet bartja e të hyrave.

z. Lulzim Gacaferi: Përshëndetje për të gjithë, po ne si grup i VV-së pajtohemi .

z. Arten Hamza: Përshëndetje për të gjithë, sa i përket kërkesës për ndryshimin e planit e të hyrave janë mjete të planifikuara për vitin 2021 dhe të inkasuara për vitin 2021, ajo diferencë të planifikohet dhe të bëhet bartja e rritjes për vitin 2022. E hedhi në votim.

Nga 15 prezent, për ishin 15, asnjë kundër, asnjë abstenim, kalon.

Pika e tretë e rendit të ditës

3. Kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2021 në vitin 2022;

z. Shpejtim Gacaferi: Sa i përket kësaj pike fjalën e kaloj të zyrtari kryesor Financiar.

z. Arten Hamza:

z. Leonard Lolluni: Grupi i AAK-së pro dy pikave dhe jemi kundër dy pikave për bartje, pro jemi të asfaltimi i rrugës Junik-Jasiq dhe të subvencionet të të infektuarit me COVID-19, gjithashtu jemi pro edhe të mallrat e shërbimet 7000 në programin e shëndetësisë, ndërsa sa i përket ndërtimeve të kanaleve të ujitjes kërkoj ta kemi një projekt detal se ku do të ndërtohen këto kanale sepse nuk e kemi të qartë se ne cilin segment do të ndërtohen si dhe të bashkë financimi i projekteve ju falemderit.

z. Shpejtim Gacaferi: Jam dakord me ty por nuk kam qenë dakord katër vite me ty, kur të bëja pyetje ty, dhe me thoshe lindje përfundim.

z. Arten Hamza: Sa i përket projektit të kanalit të ujitës është projekti i përgatitur detal përveç kur të tenderohet mund të dihet se në cilin segment do të ndërtohet, ndërsa të bashkëfinancimi i projekteve ka kërkesa të trashëguara edhe nga viti i kaluar por donatorët i kërkojnë edhe kur nënshkruhet kontrata atëherë dihet saktë se cili projekt po financohet për momentin e kemi vetëm një të Drejtorisë e Urbanizmit për detaje të përgjithshme mund t'iu sqarojnë Drejtorët e Drejtorive.

z. Leonard Lolluni: Kisha pas dëshirë që sqarimin me na dhënë Drejtoresha e Zhvillimit Ekonomik për këtë pikë.

Shpejtim Gacaferi: Ju Leonard e dini shumë mirë sa i përket delegimit të përgjegjësive për adresuar detyrat e përfaqësimit, kryetari i Komunës ka të drejtë të cakton personat se kush mund të përgjigjen, në pyetjet që kërkojnë.

z. Lulzim Gacaferi: Unë kërkoj një sqarim shtesë të rruga Junik Jasiq- Gjocaj, si është parapa të ndërtohet asfaltimi i kësaj rruge, dhe a janë të zotuar mjetet nga komuna e Junikut apo duhet të kemi mbështetje nga Qeveria Qendrore? Dihet se Komuna e Junikut me buxhetin e kufizuar e ka shumë të vështirë ta mbulojë, nëse nuk janë mjetet në dispozicion, mjetet në fjalë kisha kërkuar që këto mjete të barten në shëndetësi dhe në arsim, ne jemi të zgjedhur të punojmë për rregullimin e jetës për të gjithë qytetarët e Komunës së Junikut por ne fshatin Jasiq nuk kemi banor rezident për momentin dhe ti japim prioritet shëndetësisë dhe arsimit, nëse ka mundësi kryetari apo Drejtori i Urbanizmit me na dhënë këtë sqarim.

z. Ruzhdi Shehu kryetari i Komunës: Nuk i kemi mjetet në dispozicion por ne e kemi trashëguar si kontratë nga qeveria e kaluar një pjesë e obligimeve janë kryer në muajin Dhjetor apo në muajin Janar ne nuk kemi dashur që ta shkëpusim këtë kontratë por e kemi vazhduar projektet të cilat kanë filluar, po ashtu nuk kemi dashur që mjetet të destinohet në projekte të tjera por të destinohet mjetet në kontratat që janë aktuale të përfundojmë me këto mjete. Mjetet të cilat kërkojnë janë të kufizuara kemi të trashëguara borje por ne jemi të vendosur që ta respektojmë e Kuvendin dhe qeverinë e kaluar, që rrugën ta përfundojmë prej restorantit dhe ta lidhim ku është e paraparë sipas kontratës së nënshkruar.

z. Lulzim Gacaferi: A është rishikuar kontrata sa i përket pronave të qytetarëve a janë shpronësuar pronat?

z. Ruzhdi Shehu Kryetari i Komunës: Pyetje me vend, ne së bashku me Drejtorin e Urbanizmit e kemi rishikuar dhe kemi angazhuar personin që të bisedoj me banorët dhe ta marrim konfirmimin e tyre që nëse mundemi me vazhduar me punimet, sepse pa e marr konfirmimin nga banorët ne nuk do të fillojmë punimet, kemi pas ankës të mëdha nga pronarët sepse kanë konstatuar se nuk janë pyetur fare nga qeveria e kaluar për fillimin e punimeve për asfaltimin e rrugës. Ne nuk kemi të planifikuar buxhet për kompensimin e shpronësimit të pronave, është në interesin e dy fshatrave ndërtimi i kësaj rruge. Sa i përket kanalit të ujitjes ka mjete shumë pak të planifikuara, por do të bëhet rregullimi në lagjen Gacafer pjesa që e furnizon kanalin kryesor që e furnizon 70 % të qytetarëve.

z. Leonard Lllolluni: Kryetar aty behet fjalë për ndërtimin e një muri të një banori privat që e ka shkatërru vet pronari me eskavator.

z. Ruzhdi Shehu Kryetari Komunës: Unë Leonard nuk e kam informatën se kush e shkaktuar prishjen e kanalit por informatën e kam nga banorët sespe nuk depërton uji për ujitjen e pronave për 70 % të banorëve dhe ne urgjent do ta rregullojmë pasi që kemi ankesa dhe kërkesa nga banorët që ne afatin sa me te shkurtër të shfrytëzohet kanali për ujitje.

z. Zenel Maloku: Përshëndetje për të gjithë unë pata mu ndal te “Autobani i Jasiqit” të “Qafa e Jasiqit” a ka projekt apo shka është ka punohet? Ato punime që janë duke u kryer qytetarët janë rrezikuar. Atëherë më mirë atyre pareve me ju shti flaken për shembull kur te vjen dimri me pas rrëshqitje, mund te ketë pasoja te mëdha është më mirë mi mbledh qytetarët dhe mi bo matjen ashtu siç duhet, nëse nuk e kanë ndërmend te punohet mirë, me mirë te shtyhet edhe tri vite se të ndërtohet ashtu siç e kanë filluar. Unë drejtor kërkoj nga ju më mirë të ndërprehet se të vazhdohet edhe tjetra a është planifikuar që të ndërtohet edhe ura? Deshta të lidhna edhe të kanalet e ujitjes është dashtë të bohet matja mire e jo të kërkohen edhe 10.000.00 mjete shtesë mi bo ndërtimin për mua është e pa kuptueshme.

z. Sadri Krasniqi: Unë po kërkoj që rregullimi i kanalit në lagjen Gacafer është kërkesë urgjente për qytetarët që ti ujitin tokat, e kuptoj procedurat e tenderimit por është urgjente.

z. Lulzim Gacaferi: Deshta të ndërlidhem të kanalet e ujitjes edhe unë kam pranuar kërkesa nga qytetarët që të behet rregullimi i kanalit në lagjen Gacafer pasi që një pjesë e madhe e fermerët tanë janë të mvarun nga bujqësia dhe blegtoia. Ne ketë premtim e kemi dhënë edhe si prioritet ne fushatat para zgjedhore dhe duhet te merret seriozisht kjo kërkesë, e kuptoj buxhetin e kufizuar komunal dhe borgjet e trashëguara por banorët e lagjes “Gacafer” “Berishë” “Shehiq” “Hoxhaj” e të tjerë presin që sa me shpejt të realizohet kjo kërkesë dhe ta zhvillojnë aktivitetin e tyre të paraparë pasi që jetojnë nga prodhimtaria e tyre në tokat ne “Kallavaj” në pranverën e hershme të përfundon çështja e kanalizimeve.

Shpejtim Gacaferi: E hodhi në votim këtë kërkesë me këtë shpërndarje.

Nga 15 prezent, për ishin 9, kundër 6, asnjë abstenim, kalon kërkesa e Kryetarit.

Pika e katërt e rendit të ditës

4. Shqyrtimi i kërkesës për përbërjen e anëtareve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;

Shpejtim Gacaferi: Ne mbledhjen e fundit të kuvendit e kemi diskutuar pa emra dhe është nxjerr vendimi tani e kemi listën me përbërjen e grupeve të interesit që duhet të jënë pjesë e këtij këshilli unë po e lexoj listën:

1. **Ruzhdi Shehu kryetar i Komunës,**
2. **Rasim Syla Komandant i Policisë në Junik,**
3. **Imer Krasniqi përfaqësues i bashkësisë islame,**
4. **Avni Musliaj përfaqësues nga komuniteti halvetije,**
5. **Zejnepe Gaxherri kryesuese e Komitetit për Komunitete,**
6. **Xhevahire Krasniqi Zyrtare për Barazi Gjinore,**
7. **Xhavit Velijaj Drejtor i Drejtorisë për AKRS,**
8. **Xhavit Gaxherri përfaqësues i këshillit të prindërve në shkollat e Komunës së Junikut,**
9. **Arbër Gjota përfaqësues i Keshillave komunale për siguri në bashkësi,**
10. **Bestrim Rexhepi përfaqësues i Forcës së sigurisë së Kosovës,**
11. **Aferdita Shehu Kryesuese Ekipit veprues për siguri në bashkësi**
12. **Shkelzen Shehu – Përfaqësues i emergjencave të sigurisë,**
13. **Leonita Jasiqi Përfaqësuese e zyrës për Komunitete dhe Kthim,**
14. **Dukagjin Lllolluni përfaqësues i Shoqërisë Civile,**
15. **Arsim Shehu Përfaqësues i Komitetit të Biznesit,**
16. **Qamil Jasiqi Përfaqësues nga Komitetit i personave me Aftësi të Kufizuar,**

Shpejtim Gacaferi: Fjalën e kaloj të grupet e partive politike.

z. Sadri Krasniqi: Kryesues ne pajtohemi me përbërjen e kësaj liste.

z. Leonard Lllolluni: Falemderit kryesues ne si grup i AAK-së nuk e përkrahim këtë listë sepse me duket si liste puro LDK për shembull një pyetje kush është Bestrim Rexhepi ?

z. Ruzhdi Shehu Kryetari i Komunes : Leonard të jesh i bindur sepse as unë nuk e kam informatën kush është ne ju kemi drejtuar institucionit të na delegojnë përfaqësuesin e tyre dhe atë na kanë dërguar këtë propozim ne nuk mundem të ndërhyjmë të propozimet apo të delegimi i tyre për ne ky propozim i dërguar është i mirëseardhur.

z. Lulzim Gacaferi: Ne si grup i VV-së e përkrahim listën e përbërjes .

z. Dervish Bajraktari: Ne si grup i AAK-së jemi kundër Dukagjin Lllollunit kam qen kundër edhe ne mbledhjen e KPF-së dhe kisha kërkuar që ta sjell një dokument që cilat organizata i përfaqëson Dukagjin Lllolluni pasi që ne jemi në dijeni se asnjë aktivitet nuk e ka realizuar si OJQ.

z. Zenel Maloku: Unë jam kundër te emri i Qamil Jasiqit që e keni shti në listë si përfaqësues të personave me aftësi të kufizuar pasi që nuk i mungon asnjë gjymtyrë natyrale këmba apo dora, nëse kish qen si përfaqësues si invalidëve të luftës nuk me kish pengua fare sepse kam respekt shumë të veçantë edhe është meritë por titullin që ja paski dhënë nuk po pajtona fare.

z. Lulzim Gacaferi: Sa i përket emrit të Qamil Jasiqit në këtë listë si përfaqësues i personave me aftësi të kufizuar me siguri kryetari na jep një sqarim por për mua por edhe për të gjithë rrafshin e dukagjinit është personi me meritë dhe gëzon respekt pa fund nga të gjithë për kontributin dhe vlerat që i ka bërë dhe ne duhet të përulemi para tij dhe veprave të tij, unë mendoj se nëse një person që i ka humbur gjymtyrët nuk do të thotë që veç duhet të lindesh person me aftësi të kufizuar.

z. Shpejtim Gacaferi: Kryetari është kryetari këtij komiteti dhe nuk e ka përpiluar listën por lista është përpunuar dhe dërguar nga grupet e interesit ata e kanë vlerësuar dhe dërguar përfaqësuesit e tyre në e kemi sjellë në kuvend për ta votuar propozimet e tyre.

z. Ruzhdi Shehu Kryetari Komunës: Sa i përket emrat e të propozuarve kemi bërë kërkesë dhe secili grup i interesit i kanë dërguar Dukagjin Llojuni e ka OJQ si përfaqësues i Asmablit që janë grup i madh dhe e kanë emrin Kuvendi i Junikut.

z. Dervish Bajraktari: Kryesues kërkoj nga ju që kur të marrin fjalën anëtarët e grupit të AAK-së mos të ndërhyjnë anëtarët e grupit të LDK-së, por pasi ne të përfundojmë me diskutimin ta kërkojnë fjalën.

z. Xhemajl Tofaj: Kryesues desha të di që grupi i AAK-së a janë kundër komplet listës apo kundër individëve kishte qenë mirë të dimë?

z. Shpejtim Gacaferi: E hedhi në votim listën me këtë përbërje, kush është për?

Nga 15 prezent, për ish-in 9, kundër 6, asnjë abstenim, kalon.

Pika e pestë e rendit të ditës

5. Kërkesë për miratimin e iniciativës për bashkëpunim ndërkomunal – ndërkombëtar;

z. Shpejtim Gacaferi: Sa i përket kësaj pike para se ta kaloj fjalën të ju, fjalën e kaloj të Kryetari i Komunës.

z. Ruzhdi Shehu: Falemderit kryesues unë këtë kërkesë e kam dërguar për aprovim nga ju që ta marr aprovimin sipas legjislacionit në fuqi lidhur me vizitat apo bashkëpunimet që do të kemi në të ardhmen qoftë vendore apo ndërkombëtare për momentin nuk ka asnjë bashkëpunim konkret por në të ardhmen do të realizoj. Në sferat e ndryshme ne të mirën e të gjithë qytetarëve të Komunës së Junikut.

z. Sadri Krasniqi: Grupi e LDK-së është pro kësaj iniciative dhe e ka përkrahjen e fuqishme nga grupi janë pasi që është në të mirën e qytetarëve të Komunës sonë.

z. Leonard Lolluni: Ne si grup i AAK-së jemi pro bashkëpunimeve nder komunale edhe ndërkombëtare kryetari ka te drejtë, por kryetari nëse arrin marrëveshje me kryetar te komunës për marrëveshje për një projekt te caktuar vendimin e sjellë ne Kuvend me qëllimin e specifikuar ne këtë rast neve na ka ardhur një kërkesë që kërkon aprovim dhe nuk e dimë se me kënd do të bashkëpunon dhe cili është qëllimi i bashkëpunimit. Ne kemi realizuar bashkëpunime edhe ne te kaluarën edhe nderkomunale edhe ndërkombëtare por ka qenë e specifikuar marrëveshja e bashkëpunimit është sjell vendimi në Kuvend për aprovim.

z. Ruzhdi Shehu: Është obligative që iniciativa që merret pëlqimi dhe të aprovohet ne Kuvend, pastaj nënshkrimi marrëveshjeve të bashkëpunimit sjellët vendimi ne kuvend për aprovim .

z. Shpejtim Gacaferi: Nëse nuk ka diskutime kush është për iniciativën e kryetarit.

Nga 15 prezent, për ishin 9, kundër 6, asnjë abstenim, kalon.

Pika e gjashtë e rendit të ditës

6. Raporti i obligimeve kontraktuale për vitin 2021;

z. Shpejtim Gacaferi: Raportin e keni marr të gjithë me kohë gjithashtu një kërkesë shtesë e keni e cila është propozuar nga z. Xhemë Tofaj që erdh ne KPF.

z. Arten Hamza: E bëri sqarimin e raportit të obligimeve kontraktuale për vitin 2021.

z. Sadri Krasniqi: Unë nuk e di ku t'ia filloj me të gjitha këto obligime kontraktuale, por do të ndalna fillimisht te projekti parku i lodrave i ndërtuar në lagjen Krasniq kisha kërkuar nga kryetari apo dikush nga Drejtorët e Drejtorive të vini ta vizitoni ne çfarë gjendje është ndërtuar tmerr, gjithashtu projekti për ofrimin e shërbimeve administrative profesionale kulturore ka edhe shumë projekte të tjera kisha kërkuar një sqarim detal.

z. Lulzim Gacaferi: Unë desha të diskutoj lidhur me projektin asfaltimi i rrugëve lokale, a janë ndërtuar këto rrugë duke u bazuar ne procedura ligjore apo veq ne kohën e fushatës zgjedhore? Është shtruar asfalti edhe nëper oborrët e qytetarëve për shembull afati i kontratës i mbetur shtatë muaj, projekti tjetër ndërtimi i qendrës kulturore për agro biznes; afati mbetur dhjetë muaj deri në përfundim, projekti tjetër ndërtimi i punimeve ne shtratin e lumit “Erenik”, sa isha unë anëtar i kuvendit në mandatin e kaluar me dhejtra herë e kam përsëritur dhe kam adresuar kërkesa të ish kryetari i Komunës, që të caktohet një ekipë profesionale për mbikëqyrjen e punimeve sepse lumi erenik është pasuri e Junikut, dhe mjetet për ndërtimin e lumit Erenik janë të taksa paguesve të qytetareve të saj dhe të shkojnë ne adresën e duhur nuk po më intereson se cila kompani e ka kryer ndërtimin por është duke u prishur cop copë dita ditës dhe duke u derdhur ne Drinin e

Bardhë pjese pjesë, aty kanë punuar kompani të ndryshme kisha kërkuar nga ju që të bëhet verifikimi i kontratës; dhe të shikohen pranimi teknik nga personat përgjegjës para se ti dalin mjetet: Sepse dita ditës punimet janë duke u shkatërruar nga ndërtimi dobët, ne jemi të obliguar që të punojmë drejt për interesat e qytetarëve tanë pa dallim “Lumi Erenik” është aset të cilin na ka dhënë vetë natyra e cila është pasuria me e madhe për Komunën e Junikut. Desha të diskutoj edhe për projektin ndërtimi i memorialit për dëshmorët e Junikut të cilin me dhjetëra here kam ngritur si çështje në këtë kuvend desha të di se a ka shkuar dikush nga ju që ti vizitoj apo inspektoj ndërtimin e punimeve a janë kryer punimet sipas procedurave ligjore apo janë dal jashtë kornizave ligjore, sepse të gjithë jemi dëshmitar se tre muajt e fundit para fushatës zgjedhore janë dhënë tenderët nga qeveria e kaluar sikur ne bashqen e Ali Pashë Tepelenës, ne nuk duhet ta lejojmë që Junikun ta keqpërdorin për interesa personale sepse unë kam ardhur nga Gjermania që të punoj drejt për interesat e qytetarëve tanë, Drejtor si kërkesë të Kryetari i Komunës lidhur me ndërtimin e memorialit të dëshmoreve që ta dërgoj një grup të ingjiniere të Komunës që ti verifikoj ndërtimin e punimeve sepse ne duhet të jemi të kujdesshëm dhe ti respektojmë këto vlera sic na ka hije. Gjithashtu projekti ndërtimi i ujësjellësit në “lagjen Agim Ramadani” ka përfunduar afati i paraparë i kontratës, ky projekt ka filluar ne muajin gusht ish kryetari i komunës dhe kanë përfunduar afatet dhe nuk ju ka shkuar qytetareve uji për pije kryetar kisha kërkuar prap nga ju që të bëhet verifikimi i kontratës por edhe i kontratave të projekteve të tjera të vitit kaluar që keqpërdorimet dhe keq menaxhimi që është bërë nga Qeveria e kaluar të merren masa juridike ndaj tyre, informatat të cilat i kam marre nga banoret e lagjes uji aktual të cilët e përdorin nuk i plotëson standardet për pije andaj kërkoj nga ju Kryetar që ne afatin sa me të shkurtër të bëhet zgjidhja përgjithmonë banorëve të kësaj lagje për ujësjellësin. Projekti asfaltimi i “Rrugës Junik-Jasiq” afati i mbetur nëntë muaj, zoti kryetar ne jemi pro ndërtimit të kësaj rruge por jemi të obliguar që parandë publike ta dërgojmë aty ku është më primare sepse në fshatin Gjocaj i kemi vetëm tri familje ndërsa në fshatin Jasiq nuk banon asnjë familje, ne jemi të obliguar që të rregullojmë jetën e këtyre banoreve që të kthehen ne pronat e tyre, kisha kërkuar prap poe potencoj që të rishikohet kontrata për bartjen e mjeteve ti epet prioritet që këto mjete të kalojnë në shëndetësi sepse nuk është në gjendje të mirë dhe ka shumë nevojë për buxhet shtesë, sepse qeverisja e kaluar i ka punësuar 50 veta pa i përmbush asnjë kriter ligjor apo njerëzor dhe ka krijuar borgje.

z. Xhemë Tofaj: Unë deshta të ndërlihem të projekti ndërtimi i ujësjellësit në “lagjen Agim Ramadani”, kam kërkuar nga zyrtari kryesor financiar që të na sjellin projektin në detal se ku qëndron sepse informacionet që i kam qeveria është tërheq nga bashkëfinancimi dhe Komuna ka mbet e vetme në obligime për përfundimin e projektit dhe kisha kërkuar se dikush duhet të merr përgjegjësi për këtë projekt.

z. Leonard Lllolluni: Unë kur e shikoj këtë listë të gjitha këto projekte të realizuara dhe që janë në proces të realizimit ndihem shumë mirë, por ndihem shumë keq në anën tjetër se gjashtë muaj të qeverisjes suaj asnjë projekt i ri apo iniciativë nuk ka filluar nga qeverisja e juaj, e kam një

pyetje qe ketë pyetje është dashtë ta drejtoj Lulzimi sepse ne çdo mbledhje e ka shtruar si pyetje në kuvend kur do të fillon shërbimi 24 orësh në QKMF Dr. Ali Hoxha.

z. Shpejtim Gacaferi: Këtë pyetje do ta diskutojmë në piken e ndryshme.

znj. Lirjeta Shehu: Një pyetje për Leonard Lollunin, that qe jemi krenar për këto projekte, por a ndiheni krenar për të gjitha këto borxhe qe i keni lanë.

z. Leonard Lolluni: Replikë po prap po e potencoj jam shumë krenar, sepse janë projekte të filluara në vitin 2021, ta shohim ju cilat projekte të cilat do të realizoni për katër vite.

z. Lulzim Gacaferi: Replikë meqenëse me e parmendën emrin tim të dy kolegët e mi Zenel Maloku dhe Leonard Lolluni, kam shumë respekt dhe qe do të punojmë se bashku për interesat e qytetarëve, unë si shef i grupit tonë jam pro ndërtimit të rrugës Junik Jasiq Gjocaj por jam kundër ndërtimit të rrugës nga Laura deri të shtëpia e Qamil Jasiqit sepse nuk frekuentohet nga qytetaret e komunës sonë, jam pro ndërtimit nga shtëpia e Qamil Jasiqit deri ne Gjocaj dhe qe lidhet me Zharre kisha kërkuar nga ju qe mos te me devijohen diskutimet ju lutem me shumë respekt. Sa i përket shërbimit 24 orësh qe ja kam përmend Agron Kuqit do t'ia përmendi edhe Ruzhdi Shehut deri të realizohet kërkesa ime sepse ne kemi koalicion për bashkëqeverisje me LDK – VV-ja qendra në Junik ka qen obligative për mu si promotor qe bashkë me Besartin Xhemajlin qe qeverinë e kaluar ta dërgojmë në shtëpi për keq qeverisje, unë po ta japi fjalën qe shumë shpejt do të behet shërbimi 24 orësh dhe rëntgeni qe gjashtë vite qe është i bllokuar nga Agron Kuqi qe nuk e ka funksionuar për ti mundësuar ofrimin e shërbimeve qytetareve të Junikut qe kaqen donacion i dhuruar por z. Ruzhdi Shehu me stafin e tij shumë shpejt do të funksionalizohet.

z. Ruzhdi Shehu kryetar i Komunës: Deshta të ndërlidhem të diskutimi lidhur me mandatin e qeverisjes qe u tha e keni marr qe gjashtë muaj nuk është e vërtet sespe ne kemi filluar me qeverisjen në muajin janar dhe janë katër muaj qeverisje, sa i përket kontratave të keq menaxhueshme dhe qe janë dëmshme i kemi trashëguar nga Qeveria e kaluar e ketë do ja them e keni lenë Qendrën e Mjekësisë familjare në gjendje shumë të keqe për ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe laboratorike i keni dërguar ne bankat e njerëzve të cilët i keni mashtruar e qe kapin vlerën 105.000.00 euro të angazhuarit nuk janë fajtor por ata qe i kanë mashtruar e qe ne i kemi marr përsipër mi përfunduar obligimet e tyre të trashëguara nga ju si borgje, të gjitha obligimet kontraktuale të trashëguara nga ju janë të nënshkruara pa parashikim të mjeteve ku edhe Ministritë janë terhjekur nga bashkëfinancimi ne po mundohemi ti sajojmë këto defekte qe janë shumë të dëmshme dhe si procedura janë shkelë, për shembull ndërtimi i qendrës Kulturore të Agro Biznesit, Asfaltimi i rrugëve Lokale, ndërtimi i Rruges Junik Jasiq prej Restoranti ndërtimi i Rrugës për bjeshkë, ndërtimi i ujësjellësit në “lagjen Agim Ramadani”, gjithashtu projekti i rrugës për në fshatin Gjocaj qe e potencoj Zeneli ky projekt ka filluar prej vitit 2010 shumë pak mjete dhe prej atij viti nuk ka përfunduar, ne me mjetet të cilat i kemi ne dispozicion do të fillojmë deri ku te mbërrimë sa te ka mjete jo të vazhdohet me punime pa mjete dhe të krijojmë borgje komunale si ne te kaluarën. Gjithashtu i kemi borgjet e studenteve të cilët

kan përfituar pa ndonjë kriter që shuma e borxhit e kap vlerën 25.000.00 euro edhe këto borgje i kemi marr përsipër mi kry obligimet, të gjitha këto kontrata janë procedura të auditimit .

Pika e shtatë e rendit të ditës

7. Shqyrtimi në lexim të parë i planit të punës së Kuvendit për vitin 2022;

Shpejtim Gacaferi: Sa i përket kësaj pike në si grup i formuar nga Kuvendi e kemi kryer planin dhe ju e keni materialin sa i përket buxhetit e kemi gjetë të planifikuar, dhe nuk kemi pas mundësi me lëviz . Sa i përket kësaj pike e hapi debatin për diskutime.

z. Sadri Krasniqi: Sa i përket planit në si grup i LDK-së pajtohem.

z. Leonard Llojuni: Edhe në si grup i AAK-së pajtohem me planin e punës por në të ardhmen kur ka ndonjë pike që lidhet me kuvendin me pas mundësinë mi pasuru.

z. Lulzim Gacaferi: Edhe Grupi i VV-së pajtohet me planin e punës së Kuvendit.

z. Shpejtim Gacaferi: E hodhi në votim planin e punës së Kuvendit.

Nga 14 prezent, për ish-in 14, asnjë kundër , asnjë abstenim, kalon.

Pika e tetë e rendit të ditës

8. Të ndryshme,

z. Shpejtim Gacaferi: Para se ta hapim diskutimin për pikën e radhës, po ju rikujtoj sepse sot është dita e fundit për dorëzimin e formularëve për deklarin e pasurisë kush nuk ka arritur të dërgon. Si dhe një kërkesë lidhur me dorëzimin e materialit të kuvendit po kemi shumë të vështirë a kishte qenë e mundur që materiali kur të përgatitet me ardhur shëfat e grupeve që ta marrin meqenëse dorëzimi bëhet edhe në adresat elektronike nëse nuk paraqitet ndonjë problem për ju.

z. Zenel Maloku: Meqenëse Komuna i dërgon për postë faturat e tatimit dhe shkresat e tjera dërgoni përmes poste por nëse nuk bon atëherë për mu nuk paraqet ndonjë problem me telefononi dhe une vë që ta marr. Sa i përket kësaj pike e hapi debatin për diskutime.

z. Leonard Lllolluni: Unë kryesues jam pro dorëzimit të materialit përmes postës elektronike nuk paraqet asnjë problem bile e kursejmë shpenzimin që të kemi sa me pak printime, por edhe nëse na kërkohet që vimë direkt ti marrim në Komune unë jam pro sepse nëse i dërgojmë përmes postës së Kosovës ka vonesa të mëdha dhe materiali nuk na mbërrinë me kohë.

z. Zenel Maloku: Unë deshta të diskutoj të pika e ndryshme i kam disa kërkesa, nuk e di a ju përkasin Drejtorisë Shërbimeve Publike apo të Urbanizmit unë kam edhe ankesa lidhur me parkingun e trotuareve me vetura dhe nxënësit rrezikohen dhe ja pamundëson nxënësve që të ecin neper trotuar kom vërejtje edhe të Policia unë për 10 vjet kam bo ankesa për mos parkimin e veturave në trotuar qysh do të ndihemi na nëse na rrezikohet ndonjë nxënës unë konsideroj që kjo nuk është rregull, dhe bëjë kërkesë të Drejtorisë e Arsimit që ta vendos tabelën që mos të parkohen veturat në trotuar, gjithashtu është një tabel e vendosur te posta e cila e ka zan trotuarin që njeri nuk mund të kalon andej dhe ajo tabelë nuk e di se kujt është duke i shërbyer, me herët e kemi pas një kërkesë me herët që lapidari të xhamia kërkoj që të hiqet meqenëse emrat e të gjithëve janë të vendosur te lapidari i Edmond Hoxhës sespe nuk është e nevojshme që të behën homaxhe në dy vende për të njëjtit emra, gjithashtu deshta të kaloj edhe të ambulanta me datën 21 të këtij muaji kan shkru persona me bere analiza dhe kan thene që nuk kan material për krerjen e analizave dhe tjetra që 10 vite osht tuju diskutu puna e rengenit dhe hala nuk u rregullua punëtori paguhet dhe retngei nuk punon fare .

z. Ruzhdi Shehu Kryetari Komunës: Sa i përket kërkesave që i paraqite këto janë që 12 vite, sa i përket mjeteve nga participimi shëndetësor ato mjete kanë shkuar në pagesat e punetoreve të angazhuar jasht ligjshëm ato mjete të participimit janë të dedikuara të kthehen për shërbime shëndetësore jo të perdoren për pagesat të tjera, qeshtja e vendosjes së shenjave ato do të vendosen por do të behet shumë shpejt një plan për rregullimin e qendrës sespe ka ngushtica, sa i përket lapidarit po pajtona plotësisht me ty se është e pa nevojshme që të bëhën homazhe në dy vende për të njëjtat emra kjo qeshtje është dasht të merret vendimi në momentin kur është bërë bartje në lapidar të ri por në dote diskutojmë me të gjithë palët e interesit dhe të rregullohet kja qeshtje me dakordimin e tyre të vendosim.

z. Lulzim Gacaferi: Sa i përket shenjave të Komunikacionit duhet të merret seriozisht sespe nuk duhet të rrezikohen fëmijët apo qytetarët por të mendojmë për zgjedhjen e përhershme përmes një parkingu nëntokësor, pasi qeveria e kaluar për 12 vite nuk e mendoj kete qeshtje. Deshta të diskutoj edhe për emërtimin e rrugëve që ende Komuna e Junikut e ka emërtimin e rrugëve une kamqen në atë grup punues dhe asnjëherë nuk jam ftuar të marr pjesë në grupin punues, por me një raport të cilin e kam parë është një punë e kryer në mënyrën me të keqe që është kryer ndonjëherë poashtu emrat që janë vendosur në emërtimin e rrugëve nuk e meritojnë të jenë në ato lista me keqardhje e them, por kërkoj nga kryetari i Komunes që ta formon një grup punues që të rishikojnë këto lista dhe të kryhen këto procedura në mënyrën me të mirë sespe e vtmja Komuna e Junikut në kosovë nuk e ka emërtimin e rrugëve .

z. Zenun Shala: Sa i përket kësaj teme ne e kemi pasur një takim me agjensionin kadastral ku vetëm Komuna e Junikut nuk e ka emërtimin e rrugëve, unë kam gjetur një vendim të datës 06.03.2019 ku Kuvendi i Junikut i ka përfunduar emërimin e rrugëve por ne do ta respektojmë atë vendim dhe do të punojmë intensivisht në bashkëpunim me axhensionin kadastral që ti përfundojmë të gjitha procedurat konform dispozitave ligjore, por nëse na vjen ndonjë vendim për shfuqizimin e vendimit paraprak ne do ta respektojmë .

z. Leonard Lolluni: Unë i kam tri pyetje, pyetja e parë është për Kryetarin dhe të gjithë Drejtorët cilat janë projektet e planifikuara për vitin 2022 dhe kur do të fillojnë ? Pyetja e dytë kur do të filloni me shërbimin 24 orësh në QKMF ? Pyetja e tretë kur do të fillon ndërtimi i rrugës Junik Gjeravicë meqenëse është e kontraktuar dhe ka edhe 12 muaj afat me kontratë?

z. Ruzhdi Shehu: Ndërtimi i rrugës Junik Gjeravicë do të fillon shumë shpejt me mjetet të cilat janë në dispozicion me kompaninë aktuale por edhe kompanitë kanë shumë telashe me ngritjen e çmimeve dhe ne do ti kuptojmë, po ju garantoj që punimet nuk do të kryhen me telefon por do të kryhen me projekt detal dhe në teren, sa i përket shërbimit 24 orësh në QKMF konkursi ka dalë për 4 pozita për mjek dhe jemi në procedura të konkurrimit, ne jemi zotuar që do ta funksionojmë vullneti është mjetet janë do të realizohet shërbimi, lidhur me projektet e qeverisë për vitin 2022, ne e kemi gjetur planifikimin për vitin 2021 dhe 2022, me buxhetin e planifikuar dhe trashëguar nga qeveria e kaluar, por me rishikimin e buxhetit do të fillojmë me projektet e reja.

z. Dervish Bajraktari: Unë kam tri pyetje, kur do të fillon projekti për rregullimin e kanalizimit në lagjen Bajraktar dhe rregullimi i rrugës Bajraktar – Gaxherr që kjo rrugë është gjendje shumë të keqe, gjithashtu projekti mirëmbajtja e ndriçimit në rrugën Berishë- Nivokaz nuk ka ndriçim fare arsyeja përse është ndërpre dhe pyetja tjetër për Drejtorin e Shërbimeve publike lidhur me lokalitë në lagjen Gaxherr që e patëm si temë në mbledhjen e kaluar që leja është lëshuar si Shisha Bar edhe pse prej fillimit të aktivitetit bazuar në informatat të cilat i posedojë e ka devijuar aktivitetin. ndërsa policia para dy jave e ka bërë mbylljen deshta të di arsyen e mbylljes.

z. Demokrat Ganiqaj: Sa i përket rehabilitimit të rrugëve lokale nuk kanë qenë të vulltshme kushtet atmosferike për rregullimin e asaj rruge por në afatin sa me të shkurtër do të rregullohen, lidhur me ndriçimin ku e potencojë ne i kemi zhvilluar procedurat lidhur me projektin për mirëmbajtjen e ndriçimit në momentin që të perzgjedhet operatori ekonomik do të evitohen të gjitha problemet, lidhur me lokalitë, në mbledhjen e kaluar e kam potencuar se leja është dhënë për shisha bar por në momentin që do të bëhet devijimi i aktivitetit do të bëhet mbyllja sespe kaqen në monitorimin tanë dhe të policisë.

z. Sadri Krasniqi: Une i pata 4 kërkesa por disa edhe u diskutuan rregullimi kanalit të ujitjes në lagjen Gacafer si kërkesë urgjente, parku i lodrave në lagjen Krasniq të largohen sespe është në gjendje të mjerueshme, e kam si shqetësim lidhur me pastrimin e mbeturinave, kamijoni i cili i ben bartjen bënë ndalesa të shpeshta me këtë rast e bene edhe zbrazjen e ujit në rrugë kryesore dhe neper lagje e cila kundërmon arom ekstrem të keqe sidomos në sezonin e verës une kam biseduar

me kompanin përgjegjëse por e kam paraqite edhe si kërkesë para 7 viteve, ne bisedat te cilat i kam pas me kompanin janë ankuar te qytetaret sespe ne hudhjen e mbeturinave ka gjana të langshme. Gjithashtu deshta të paraqes si kërkesë të Drejtori i Shendetësisë që në QKMF -ja të paiset me telefon fiks sespe per momentin nuk e kishin, që për qytetaret është shqetësuese se nuk e kan mundësin që të bëjnë telefonata lidhur me shërbimet e nevojshme sido mos moshat e vjetra.

z. Demokrat Ganijaj: Sa i përket kompanisë për mbeturinat ne kemi pranuar ankesa edhe nga qytetaret, por ne kemi vepruar shumë shpejt inspektorët kan bere inspektimin e shërbimeve i është dhënë vërejtje nëse vazhdon me avancin e njejt do të veprojmë sipas procedurave ligjore në fuqi.

Z. Leonard Lolluni : Sa i përket debatit për menaxhimin e mbeturinave jeni duke e përgatitur terenin që të kalon ne menaxhim të Kompanisë “Higjiena” të kryetari i Komunës së Pejës Gazmend Muhaxheri do të jemi dëshmitar të gjithë, se shumë shpejt menaxhimi i mbeturinave do të kalon te kompania “Ambijenti” në Pejë, me këtë rast do të mbesin edhe 5 punëtorë Junikas pa punë.

z. Lulzim Gacaferi: Meqenëse prezent është Drejtori i Shërbimeve Publike me vjen mirë që u hap diskutimin e për grumbullimin e mbeturinave të gjithë prej neve na gëzon fakti që e kemi kompaninë Junikase që e benë menaxhimin e mbeturinave por edhe kompania duhet të ofroj shërbime të mira dhe cilësore dhe duhet ta bene rregullimin e kamionit që e benë bartjen e mbeturina që mos ta bene ndotjen e ambijenitit gjithashtu duhet te mendohet që bëhet zgjidhja e menjëhershme te deponija e hudhjes se mbeturinave sespe ishe ne gjendje shumë të keqe. Gjithashtu e kam një lutje Drejtorin e Shendetësisë lidhur me aparatën e Retngjenit që ka ardh si Donacion nga Qeverija Japonisë që ne afatin sa me te shkurt të vihet në funksion për sepse me dhjetëra herë e kam ngritë si qeshtje ne Kuvend është thënë që qe duhet dhoma e posaqme per të është përfunduar, duhet të caktohet nje infermier që duhet të ofroj shërbime të Retgenit është licencuar edhe infermieri edhe defektet e energjisë elektrike janë riparuar dhe tash e sa vite nuk është në funksion për ofrimin e shërbimeve për qytetaret tanë, por kërkoj nga ju Drejtor të na jepni sakt premtimin kur do të jetë në funksion.

z. Fatos Shala: Jemi duke punuar se bashku me Drejtorin e QKMF-së që ne afatin sa me të shpejt që ky aparat i rëntgenit të jetë në shërbim për pacientët e Junikut.

z. Demokrat Ganijaj: Unë do të përgjigjem Leonardit dhe Lulzimit sa i për menaxhimin të mbeturinave unë qdo ditë se bashku me inspektorët komunal e bëjmë inspektimin e shërbimeve, nuk mund të themi se gjendja është e mirë por jemi duke punuar që të bëjmë një zgjidhje afatgjate në bashkëpunim me Organizatën Gjermane GIZ. Gjithashtu u diskutua edhe qeshtja për vendosjen e shenjave të komunikacionit, ne si Drejtori i kemi filluar procedurat për iniciimin e projektit do të bëhet vendosja e shenjave dhe rregullimi i parkingjeve por zbatimin dhe respektimin e tyre duhet ta bëjnë Policia dhe qytetarët.

z. Sadri Krasniqi: Deshta të diskutoj lidhur me menaxhimin e mbeturinave u ndjeva si i akuzuar nga diskutimi i Leonardit që u ngrit si debat i ashpër që kinse po pergaditet terreni që menaxhimin

e mbeturinave ti ipet kompanisë nga Komuna e Pejës, ne 7 vite me herët kemi dërguar kërkesa edhe ne policinë e Junikut që të evitohet problemi lidhur me ndotjen e ambientit nga bartja e mbeturinave nga kompania, unë jam ithtar për mbrojtjen dhe përkrahjen kompanive Junikase që ofrojnë shërbime për qytetaret tanë.

z. Zenel Maloku: Unë kam një pyetje cili është problemi që aparati i rëntgenit tash e sa vjet nuk është në funksion për ofrimin i shërbimeve për pacientët tanë?

znj. Rajmonda Krasniqi: Lidhur me një shakt i hapur gjatë gjithë kohës në thellësi prej 10 metrave në lagjen Krasniq, që fëmijët tanë janë të rrezikuar që për ne si familjar është shqetësuese për qdo ditë ardhja dhe vajtja në shkolle, kërkoj nga ju që të merren veprime të menjëhershme për evitimin e këtij problemi.

z. Demokrat Ganijaj: Po ne si Drejtori kemi dal në vendin e ngjarjes dhe brenda ditës do të bëhet rregullimi i kësaj pusete.

z. Lulzim Gacaferi: Unë desha të diskutoj për Arsimin, bazuar në informacionet që posedoj shkollat tona në gjysmën e dimrit kanë mbetur pa furnizim me dru, që për mendimin tim është e pa pranueshme ky veprim, po ashtu në shkollat tona profesorët që janë punësuar nuk posedojnë diploma fare dhe janë punësuar sipas interesave partiake pa asnjë kriter dhe jo adekuat në profesion, këta profesor i edukojnë fëmijët tanë që nuk tregojnë cilësi fare, kisha kërkuar nga Drejtori i Arsimit të bëjë verifikimin e tyre për të mirën e fëmijëve tanë, sepse kemi kuadro profesionale në Junik që nuk ju është dhënë mundësia që të jenë pjesë e procesit edukativo-arsimor, por në vendin e tyre janë vendosur njerzit jo adekuat dhe pa diploma universitare, ne për profesorët e të kaluarës mburremi me punën të cilën e kanë bërë dhe kuadrot të cilët kanë dalë.

z. Zenel Maloku: Degjova që shkollat e Komunës së Junikut paskan mbetur pa dru në gjysmën e dimrit Ministria e Arsimit i ka qit mjetet përse me ndodh ky problem a jon qit drutë veç për deri në gjysë të dimrit apo deri në pranverë desha të na tregon Drejtori i Arsimit.

z. Xhavit Velijaj: Me të vërtetë ne e kemi gjetur gjendjen jo të mirë të furnizimit me dru që në muajin Janar janë hargjuar, por ne kemi vepruar në formën me të shpejtë dhe është sanuar problemi, procedurat e tenderimit kanë shkuar sipas mënyrës më të mirë por problemi kryesor ka qenë se drutë kanë ardhur shumë të masës së hollë, unë kam dëgjuar se kinse shkollat kanë mbetur pa furnizim me dru po ju garantoj që në asnjë moment shkollat nuk kanë mbetur pa ngrohje, sa i përket kuadrit profesional ne e kemi gjetur gjendjen të cilën është por nuk janë të kualifikuar por kanë kontratë 1 vjeçare dhe do të hapen konkurset, ne kemi hapur konkursin publik në shkollën fillore për 4 pozita dhe janë procedurë sipër dhe shumë do të kryhet procedura e rekrutimit për plotësimin e kuadrit arsimor.

znj. Rajmonda Krasniqi: Unë e kam një shqetësim lidhur me mbi ngarkesën e çantave për fëmijët të cilët e kanë qdo ditë a kish pas mundësi që materialit të lejohet shkollë dhe ta bartin në shtëpi vetëm materialin që kanë mi shtjellu si detyrë shtëpi, sepse këtë shqetësim e kam marrë edhe nga

shumë prindër të tjerë edhe ne si prind jemi të gatshëm të kontribuojmë në qfar do zgjidhje sespe me te vërtet janë të mbi ngarkuara me bartjen e materialit.

z. Xhavit Velijaj: Une besoj qe zgjidhja do të bëhet ne përfundimin e objektit të shkollës se re ne fund të dhjetorit dhe do të kete hapsire edhe vendosjen e materiale neper klasët ku mësojnë besoj qe Ministria e Arsimit do ta bene inventarizimin e dollapëve, por nëse kja nuk do të ndodh ne do ta bëjmë zgjedhjen e këtij problemi.

z. Leonard Lllolluni: Meqenëse u diskutuat qeshtja e furnizimit me dru per shkollat nuk qëndron problemi te qeverisja e kaluar, unë mesa e posedoj informatën nuk hap tender Komuna sa i përket furnizimeve me dru Ministria e Arsimit e hap tenderin për të gjitha shkollat per ti furnizuar me dru, por komisioni per pranimin e furnizimeve është dashur të bëjë me kujdes matjen e druve qe a përkojnë vërtet me kërkesat e dorëzuara nga shkollat, atëherë gabimi është i Komisionit.

z. Xhavit Velijaj: Hapjen e tenderit për furnizime me dru e ka bërë Komuna e Junikut vitin e kaluar, gjithashtu ne jemi ne procedurë e sipër per përgatitjen e procedurave per hapjen e tenderit për furnizime me dru për këtë vit dhe vitin e ardhshëm me 250 metra kub .

z. Lulzim Gacaferi: Deshta të paraqes edhe një kërkesë lidhur me paisjen e Kuvendit me zerim sespe po kam shumë probleme me dëgjimin kur po behen diskutimet, kisha kërku qe të shikohen mundësit qe sa me shpejt të realizohet kjo kërkesë, une kontribuoj 50 % të mjeteve nga vetë financimi im nuk e di sa me lejohet të kontribuoj, e kuptoj se ndoshta projekti i zerimit ka kosto të madhe gjë që për Komunën tanë është e pa përballueshme me buxhetin e kufizuar të cilin e ka, por të shikohen të gjitha mundësitë.

z. Leonard Lllolluni: Kryesues meqenëse e kemi buxhetin e kuvendit qe gjatë mbajtjes se seancave të kuvendit të na servohet nja nje shishe e ujit.

